



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS
INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT**

**PROGRAM ORIENTUES PËR PËRGATITJEN E PROVIMIT
KOMBËTAR TË MATURËS SHTETËRORE
PËR SHKOLLAT E MESME**

NË LËNDËN:

EKONOMI E THELLUAR

VITI MËSIMOR 2012-2013

1. UDHËZIME PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT

Programi orientues i Maturës Shtetërore për lëndën “Ekonomi e thelluar”, përfshin konceptet më të rëndësishme të ekonomisë, si dhe njohuritë dhe aftësitë themelore që i duhen nxënësit në këtë nivel të avancuar të lëndës. Ky program është hartuar bazuar në programin e Ekonomisë bërthamë dhe të avancuar të gjimnazit.

Programi orientues i Maturës Shtetërore, për provimin me zgjedhje të lëndës së *Ekonomisë së thelluar*, për vitin shkollor 2012-2013, përbën një dokument të vlefshëm për mësuesit e gjimnazit, nxënësit e interesuar dhe specialistët e përfshirë në procesin e hartimit dhe vlerësimit të testit të Maturës Shtetërore.

- Programi përmban dhe siguron informacionin e nevojshëm për mësuesit e Ekonomisë së gjimnazit që do të përgatisin maturantët për provimin e *Ekonomisë së thelluar*, si lëndë me zgjedhje në Maturën Shtetërore 2012-2013.
- Programi orienton nxënësit për njohuritë, konceptet dhe aftësitë kryesore që duhet të zotërojnë për të përballuar me sukses provimin e *Ekonomisë së thelluar*, si lëndë me zgjedhje në Maturën Shtetërore.
- Programi përbën një dokument zyrtar që duhet zbatuar me korrektesë nga specialistët e përfshirë në hartimin e bankës së pyetjeve dhe tezës së provimit të ekonomisë-bërthamë-avancim, si lëndë me zgjedhje për Maturën Shtetërore.

Ky program duhet shqyrtuar me kujdes nga secili prej grupeve të interesit. Specialistët e përfshirë në hartimin e bankës së pyetjeve dhe tezës së provimit të ekonomisë-bërthamë-avancim, si lëndë me zgjedhje për Maturën Shtetërore, duhet të mbajnë në vëmendje që nuk duhet të përfshijnë për vlerësim objektiva mësimorë, të cilët nuk janë parashikuar në këtë program. Banka e pyetjeve dhe teza e provimit duhet të përmbajnë vetëm ato koncepte, njohuri dhe aftësi të parashikuara në këtë program.

Mësuesit që do të përgatisin nxënësit për provimin e Maturës Shtetërore në lëndën e *Ekonomisë së thelluar*, duhet të mbështeten në objektivat e këtij programi orientues, në mënyrë që të aftësojnë nxënësit për të përvetësuar të gjitha njohuritë, konceptet dhe aftësitë e përcaktuara në këtë program. Për këtë qëllim, mësuesi dhe nxënësi duhet të shfrytëzojë disa materiale burimore.

2. LINJAT DHE NËNLINJAT PËR EKONOMINË BËRTHAMË

LINJA: EKONOMIA E TREGUT

Përshkrimi i linjës: Kjo linjë fokusohet në krijimin të nxënësi/ja të koncepteve dhe arsyetimeve ekonomike mbi vendimmarrjen në kushtet e burimeve të kufizuara ekonomike. Nëpërmjet kuptimit dhe analizës së këtij fakti, krijohet një kuptim i qartë ekonomik mbi idenë se të gjitha zgjedhjet ekonomike shoqërohen me një kosto.

Nxënësit njihen me veprimin e ligjit të kërkesës dhe të ofertës në ekonominë e tregut dhe pajisen me mjetet e analizës, të cilat ata mund t'i përdorin edhe në linjat e tjera. Gjithashtu, nxënësit njihen e diskutojnë për parimet mbi të cilat bazohet vendimmarrja e firmave, financimi i tyre, si dhe nivelet e konkurrencës së tregut.

Ç'është ekonomia dhe faktorët e prodhimit, problemi ekonomik themelor dhe sistemet ekonomike, shtyllat e sipërmarrjes së lirë, skema e qarkullimit të aktivitetit ekonomik, kërkesa, oferta, ekuilibri i tregut, kontrolli i çmimeve nga forcat jo të tregut, konsumatori, burimet e të ardhurave dhe kursimi, buxheti vetjak, planifikimi i tij, sipërmarrësi, biznesi i vogël dhe roli ekonomik i tij, format e organizimit të biznesit, burimet financiare të biznesit, tregu i letrave me vlerë, kontabiliteti i biznesit, prodhimi, kostoja, të ardhurat e firmës, konkurrenca e plotë, konkurrenca monopoliste, monopoli, oligopoli, tregu i punës, aspekte të tjera të tregut të punës, tregu i kapitalit dhe i tokës janë tematika të mundshme për t'u trajtuar në këtë linjë.

Nënlinja	Objektivat
1.1 Çfarë studion ekonomia?	Nxënësi/ja duhet: <ul style="list-style-type: none">▪ të shpjegojë konceptet: pamjaftueshmëri, sistem ekonomik, kosto oportune dhe lidhjen shkakësore ndërmjet pamjaftueshmërisë dhe nevojës për të zgjedhur, duke pranuar koston oportune;▪ të identifikojë faktorët e prodhimit për një të mirë ose shërbim;▪ të interpretojë një lakore të mundësive të prodhimit, si dhe nëpërmjet saj të ilustrojë koston oportune;▪ të vlerësojë mënyrën se si sisteme të ndryshme ekonomike e zgjidhin problemin ekonomik themelor;▪ të përshkruajë veçoritë e shtyllave të sistemit ekonomik të iniciativës së lirë.

1.2. Kërkesa, oferta dhe çmimi i tregut	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Të interpretojë konceptet: treg, çmim, kërkesë, ofertë; ▪ të formulojë ligjin e kërkesës dhe të ofertës; ▪ të interpretojë lakoren e kërkesës dhe të ofertës; ▪ të shpjegojë faktorët që shkaktojnë zhvendosjen e kërkesës dhe ofertës; ▪ të përcaktojë, nëpërmjet grafikut, çmimin ekuilibër të një produkti të dhënë, kur janë dhënë kërkesa dhe oferta për këtë produkt; ▪ të bëjë dallimin midis një ndryshimi në sasinë e kërkuar apo ofruar dhe një ndryshimi në kërkesë apo ofertë; ▪ të vlerësojë ndikimin e ndryshimeve të elasticitetit të kërkesës në sasinë e kërkuar dhe të ndryshimeve të elasticitetit të ofertës në sasinë e ofruar; ▪ të shpjegojë se si ndikojnë në çmimin e tregut ndryshimet në kërkesë dhe ofertë; ▪ të analizojë ndërveprimin e ligjit të kërkesës dhe ofertës në çmimin ekuilibër; ▪ të dallojë çmimin tavan nga çmimi dysheme.
1.3. Konsumatori në ekonominë e tregut	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Të përshkruajë rëndësinë ekonomike të konsumatorit në ekonominë e tregut, si dhe burimet e të ardhurave të individëve dhe format e tyre; ▪ të shpjegojë arsyet pse njerëzit kursejnë; ▪ të analizojë faktorët që ndikojnë në masën e kursimit.
1.4. Fillimi i një biznesi dhe financimi i tij	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Të listojë format kryesore të organizimit të biznesit; ▪ të gjykojë mbi avantazhet dhe disavantazhet e secilës prej tri formave kryesore të biznesit; ▪ të shpjegojë organizimin e korporatës; ▪ të dallojë ndryshimin midis aksionit dhe obligacionit; ▪ të analizojë një bilanc dhe një pasqyrë të rezultateve financiare të firmës.
1.5. Prodhimi, kostoja dhe të ardhurat e firmës	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Të bëjë dallimin midis kostove fikse dhe atyre variabël; ▪ të llogaritë koston e përgjithshme të prodhimit, koston mesatare dhe atë marxhinale; ▪ të llogaritë të ardhurat e përgjithshme, të ardhurat marxhinale dhe të ardhurat mesatare; ▪ të llogaritë produktin e përgjithshëm, marxhinal, mesatar; ▪ të shpjegojë funksionin e prodhimit për periudhën afatshkurtër.
1.6. Struktura e tregut	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Të interpretojë konceptet e konkurrencës dhe strukturës së tregut; ▪ të shpjegojë karakteristikat e secilës prej strukturave kryesore të tregjeve: konkurrencë e plotë, konkurrencë monopoliste, oligopol, monopol; ▪ të diskutojë raportet dhe format e shkrirjes së bizneseve; ▪ të krahasojë strukturat e ndryshme të tregjeve.

LINJA: EKONOMIA KOMBËTARE

Përshkrimi i linjës: Aktivitetet ekonomike të qeverisë ndikojnë në mirëqenien tonë të përditshme. Njohja me rolin dhe funksionet që ka një qeveri në ekonominë e tregut, dhe identifikimi e analiza e problemeve të ndryshme, si: papunësia, inflacioni, rënia ekonomike, do të ndihmojë nxënësit që të kuptojnë më mirë realitetin makroekonomik, si dhe politikat fiskale apo monetare që ndiqen për stabilitetin e ekonomisë. Në këtë linjë, nxënësit mësojnë gjithashtu përmbajtjen, funksionet dhe format e parasë në një ekonomi monetare, si dhe rolin e bankave tregtare dhe të Bankës Qendrore. Roli i qeverisë në ekonomi, buxheti i qeverisë, taksat dhe llojet e tyre, deficitit buxhetor dhe borxhi kombëtar, paraja format dhe oferta e parasë, bankat tregtare dhe roli i tyre, banka qendrore, produkti i brendshëm bruto, inflacioni, cikli i biznesit, papunësia, matja dhe format e saj, politika fiskale, politika monetare janë tematika të mundshme për t'u trajtuar në këtë linjë.

Nënlinja	Objektivat
2.1. Qeveria dhe ekonomia	Nxënësi/ja duhet: <ul style="list-style-type: none">▪ Të përshkruajë disa nga të ardhurat kryesore dhe shpenzimet në buxhetin për qeverinë shqiptare;▪ të vlerësojë taksat, bazuar në parimet e vendosjes së tyre;▪ të krahasojë tipat e ndryshëm të taksave, duke përfshirë taksat progresive, regresive dhe proporcionale;▪ të interpretojë konceptet e deficitit buxhetor dhe të borxhit publik, si dhe të shpjegojë lidhjen midis tyre.
2.2. Paraja dhe institucionet financiare	<ul style="list-style-type: none">▪ Të interpretojë konceptin e parasë, karakteristikat e saj dhe funksionet e parasë në një ekonomi monetare;▪ të shpjegojë rolin e veçantë të bankave si pranuese depozitash dhe dhënese huash për ekonominë;▪ të përshkruajë organizimin dhe funksionet e Bankës Qendrore të Shqipërisë.
2.3 Treguesit kryesorë makroekonomikë	<ul style="list-style-type: none">▪ Të shpjegojë konceptin e GDP-së dhe se çfarë përfshihet në llogaritjen e GDP-së;▪ të përshkruajë metodat e matjes së GDP-së;▪ të shpjegojë kuptimin mbi inflacionin, deflacionin;▪ të analizojë ndikimin ekonomik të inflacionit dhe format kryesore të inflacionit;▪ të shpjegojë fazat kryesore të ciklit të biznesit.▪ të shpjegojë konceptin e forcës punëtore;▪ të dallojë format kryesore të papunësisë.
2.4. Stabiliteti ekonomik dhe politikat makroekonomike	<ul style="list-style-type: none">▪ Të përshkruajë mjetet e politikës fiskale;▪ të përshkruajë instrumentet e politikës monetare;▪ të dallojë instrumentet e politikës monetare nga ato të politikës fiskale.

LINJA: MARRËDHËNIET EKONOMIKE NDËRKOMBËTARE

Përshkrimi i linjës: Vendet dhe ekonomitë e tyre po ndërveprojnë dhe ndërlidhen gjithnjë e më shumë me njëra-tjetrën, duke pasur përfitime. Kuptimi mbi tregtinë e lirë, proteksionizmin, si dhe kursin e këmbimit valutor do t'i ndihmojë nxënësit të kuptojnë më mirë ndërvarësinë globale ekonomike të vendeve. Tregtia ndërmjet vendeve dhe përfitimet e saj, tregtia e lirë dhe politika proteksioniste, kursi i këmbimit valutor dhe bilanci i pagesave janë tematika të mundshme për t'u trajtuar në këtë linjë.

Nënlinja	Objektivat
3.1 Tregtia ndërkombëtare	Nxënësi/ja duhet: <ul style="list-style-type: none">▪ Të shpjegojë konceptet e përparësisë absolute dhe krahasuese;▪ të përshkruajë disa pengesa në tregtinë ndërkombëtare;▪ të bëjë dallimin midis bilancit të pagesave dhe bilancit tregtar.

3. PESHAT E LINJAVE DHE NËNLINJAVE PËR EKONOMINË BËRTHAMË

LINJA/NËNLINJA	PESHA NË %
Linja 1	56%
1.1 Çfarë studion ekonomia	10%
1.2. Kërkesa, oferta dhe çmimi i tregut	19%
1.3. Konsumatori në ekonominë e tregut	3 %
1.4. Fillimi i një biznesi dhe financimi i tij	11%
1.5. Prodhimi, kostoja dhe të ardhurat e firmës	7%
1.6. Struktura e tregut	6%

Linja 2	39%
2.1. Qeveria dhe ekonomia	11%
2.2. Paraja dhe institucionet financiare	6%
2.3 Treguesit kryesorë makroekonomikë	16%
2.4. Stabiliteti ekonomik dhe politikat makroekonomike	6%
Linja 3	5%
3.1 Tregtia ndërkombëtare	5%

3. LINJAT DHE NËNLINJAT PËR EKONOMINË E AVANCUAR

LINJA: EKONOMIA E TREGUT

Përshkrimi i linjës: Kjo linjë fokusohet në thellimin tek nxënësi të koncepteve dhe arsytimeve ekonomike mbi vendimmarrjen në kushtet e burimeve të kufizuara ekonomike. Nëpërmjet kuptimit dhe analizës së këtij fakti, krijohet një kuptim i thellë ekonomik mbi idenë se të gjitha zgjedhjet ekonomike shoqërohen me një kosto.

Nxënësit vlerësojnë dhe analizojnë qëllimet sociale të një ekonomie, veprimin kompleks të ligjit të kërkesës dhe ofertës në ekonominë e tregut dhe pajisen me mjetet e analizës që ata mund t'i përdorin edhe në linjat e tjera. Gjithashtu, ata njihen e diskutojnë mbi sjelljen konsumatore dhe maksimizimin e dobishmërisë marxhinale dhe bëjnë një analizë krahasuese të strukturave të tregut, të parimeve mbi të cilat bazohet vendimmarrja e firmave në nivele të ndryshme të konkurrencës së tregut.

Nënlinja	Objektivat
1.1. Qëllimet sociale të një ekonomie	<p>Nxënësi/ja duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Të shpjegojë duke i listuar objektivat sociale të një ekonomie.
1.2. Kërkesa dhe oferta: si funksionojnë tregjet	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Të llogaritë koeficientin e elasticitetit të kërkesës dhe të ofertës në lidhje me çmimin duke nxjerrë konkluzione bazuar në të; ▪ të identifikojë mallra elastike, jo elastike në kërkesë dhe ofertë; ▪ të analizojë faktorët që ndikojnë në elasticitetin në kërkesë dhe ofertë; ▪ të interpretojë lakoren e mallrave elastike, joelastike dhe me elasticitet njësi, në kërkesë dhe ofertë; ▪ të shpjegojë lloje të tjera elasticiteti, si elasticiteti i kërkesës lidhur me të ardhurat dhe elasticiteti i tërthortë i kërkesës.
1.3. Sjellja konsumatore dhe maksimizimi i dobishmërisë	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Të interpretojë dobishmërinë marxhinale zbritëse dhe ▪ ligjin e dobishmërisë marxhinale zbritëse; ▪ të gjejë ekuilibrin e konsumatorit; ▪ të bëjë zgjedhje racionale në shpenzimin e të ardhurave në para të kufizuara, bazuar në preferenca të mirë përcaktuara.
1.4. Sipërmarrës i suksesshëm. Si të bëhesh i tillë	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Të analizojë përparësitë dhe disavantazhet e biznesit të vogël dhe për të konkluduar në rolin që ka ky biznes në sistemin e ekonomisë së tregut.
1.5. Prodhimi, produktiviteti dhe tregu i punës	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Të llogarisë prodhueshmërinë dhe japë kuptimin e saj; ▪ të bëjë dallimin midis prodhimit dhe prodhueshmërisë; ▪ të analizojë faktorët që ndikojnë në prodhueshmëri dhe efektet që kanë ato në standardin e jetesës së vendit. ▪ të shpjegojë funksionimin e tregut të punës.
1.6. Analizë krahasuese e strukturave të tregut dhe rregullimi i monopolit	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Të përcaktojë nivelin e prodhimit në të cilën firmat maksimizojnë fitimin në struktura të ndryshme tregu; ▪ të analizojë vendimmarrjet e firmave në struktura të ndryshme tregu si dhe sjelljet e firmave në struktura të ndryshme tregu si në periudhën afatshkurtër dhe në periudhën afatgjatë.

LINJA 2: EKONOMIA KOMBËTARE

Përshkrimi i linjës: Kjo linjë fokusohet në thellimin e të kuptuarit mbi rolin e qeverisë në një ekonomi dhe identifikimin e disa problemeve me të cilat, përballet qeveria në realizimin e funksioneve të saj ekonomike. Në këtë linjë instrumentet e analizës marxhinale do të lejojnë nxënësit të bëjnë një diskutim më të plotë dhe më të thellë të shërbimeve publike dhe eksternaliteteve, si dhe zbatimit të politikave fiskale të qeverisë për zgjidhjen e problemeve ekonomike.

Nënlinja	Objektivat
2.1. Roli i qeverisë në ekonomi, një vështrim i gjerë	Nxënësi/ja duhet: <ul style="list-style-type: none">▪ Të argumentojë domosdoshmërinë e ndërhyrjes së shtetit në ekonomi;▪ të analizojë disa nga problemet me të cilat përballet qeveria në realizimin e veprimtarisë së saj ekonomike si dhe politika të ndryshme të qeverisë mbi ligjet antimonopol, zhvillimin dhe mbështetjen e sektorit privat, reduktimin e varfërisë, ndotjen e mjedisit etj.
2.2. Politika monetare dhe mekanizmi i transmisionit	<ul style="list-style-type: none">▪ Të shpjegojë komponentët e ofertës monetare dhe përbërësit e tyre dhe se si krijon para sistemi bankar duke dhënë kredi;▪ të analizojë objektivat, qëllimet dhe instrumentet e politikës monetare;▪ të shpjegojë instrumentet bazë monetare dhe përdorimin e tyre;▪ të analizojë efektin e instrumenteve monetare në stabilizimin e çmimeve, rritjen ekonomike;▪ të shpjegojë si Banka Qendrore rregullon ofertën monetare për të nxitur punësimin dhe stabilitetin e çmimeve.
2.3. Njohuri të thelluara makroekonomike	<ul style="list-style-type: none">▪ Të analizojë kuptimin e GDP për frymë e shprehur në çmime aktuale dhe çmime konstante;▪ të shpjegojë thelbin e metodës së prodhimit, shpenzimeve dhe të ardhurave në matjen e produktit të përgjithshëm dhe të llogaritë produktin e përgjithshëm sipas metodës së shpenzimeve, të të ardhurave dhe të prodhimit;▪ të shpjegojë kërkesën tërësore dhe faktorët që ndikojnë në të.▪ të krahasojë modelin makroekonomik klasik dhe kejnsonian të ekuilibrit;▪ të llogarisë normën e inflacionit dhe normën e papunësisë.

LINJA 3: MARRËDHËNIET EKONOMIKE NDËRKOMBËTARE

Përshkrimi i linjës: Vendet dhe ekonomitë e tyre po ndërveprojnë dhe ndërlidhen gjithnjë e më shumë me njëra-tjetrën duke pasur përfitime. Zbërthimi i thelbit të tregtisë së lirë, proteksionizmit dhe proceseve të tjera integruese ekonomike midis vendeve, do t'i ndihmojë nxënësit të analizojnë më mirë ndërvarësinë globale ekonomike të vendeve dhe përfitimet që ato kanë.

Nënlinja	Objektivat
3.1. Bashkëpunimi ekonomik dhe proceset integruese	Nxënësi/ja duhet: <ul style="list-style-type: none">Të shpjegojë thelbin e bashkëpunimit ekonomik midis vendeve, si dhe hapat e proceset integruese në këtë bashkëpunim ekonomik.
3.2. Zhvillimi ekonomik dhe varfëria	<ul style="list-style-type: none">Të shpjegojë se mirëqenia e një vendi varet nga niveli i zhvillimit ekonomik të tij;të analizojë tregues të nivelit të varfërisë në vendin tonë dhe të nxjerrë konkluzione nga kjo analizë.

3. PESHAT E LINJAVE DHE NËNLINJAVE PËR EKONOMINË E AVANCUAR

LINJA/NËNLINJA	PESHA NË %
Linja 1	51%
1.1. Qëllimet sociale të një ekonomie	3%
1.2. Kërkesa dhe oferta: si funksionojnë tregjet	17%
1.3. Sjellja konsumatore dhe maksimizimi i dobishmërisë	8%
1.4. Sipërmarrës i suksesshëm. Si të bëhesh i tillë	3%
1.5. Prodhimi, produktiviteti dhe tregu i punës	13%
1.6. Analizë krahasuese e strukturave të tregut dhe rregullimi i monopolit	7%

Linja 2	40%
2.1. Roli i qeverisë në ekonomi, një vështrim i gjerë	6%
2.2. Politika monetare dhe mekanizmi i transmisionit	17%
2.3. Njohuri të thelluara makroekonomike	17%
Linja 3	9%
3.1. Bashkëpunimi ekonomik dhe proceset integruese	3%
3.2. Zhvillimi ekonomik dhe varfëria	6%
Totali	100%